

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË**

SINTAKSA DIALEKTORE, I

**KONFERENCË SHKENCORE KOMBËTARE
MBAJTUR MË 23 dhjetor 2016**

Tiranë, 2018

**REDAKSIA: Prof. as. dr. Enkeleida Kapia
Prof. dr. Anila Omari
Prof. dr. Artur Lama
Prof. as. dr. Anila Kananaj**

Faqosi: Engjëllushe Karaj

© Copyright ASA, IGjL

ISBN 978-9928-289-12-4

PASQYRA E LËNDËS

| Paneli kryesor | | <i>Page</i> |
|-----------------------|--|-------------|
| Enkeleida KAPIA | Analizë e tipareve sintaksore në studimet e serisë “Dialektologjia Shqiptare”..... | 9 |
| Bahri BECI | Dukuritë sintaksore në pyetëtorët dhe studimet përgjithësuese për shqipen dialektore..... | 29 |
| Mehmet ÇELIKU | Dukuri sintaksore me interes dialektor në gjuhën shqipe..... | 49 |
| Kolec TOPALLI | Sintaksa popullore në epikën legjendare... | 59 |
| Rami MEMUSHAJ | Veçori sintaksore të të folmeve të labërishtes..... | 65 |
| Flora KOLECI | Analizë e disa ndërtimeve me trajtën e infinitivit në të folmen toske, gege dhe arbëreshe..... | 73 |
| Giuseppina TURANO | | |
| Anila OMARI | Tipare dalluese sintaksore në shqipen e shekullit XVII sipas tekstit të Bogdanit krahasuar dhe më tekstet paraardhëse..... | 95 |
| Andrey N. SOBOLEV | Syntactic variation in Albanian according to the “Minor Atlas of Balkan Dialects”... | 125 |
| Artur LAMA | Tipare dalluese sintaksore në lirikën popullore të Jugut (gjymtyrët e fjalisë).... | 133 |
| Berton SULEJMANI | Gjendja e sotme dhe perspektiva e studimeve sintaksore për të folmet shqipe në Maqedoni..... | 155 |

| | | |
|--|--|-----|
| Nexhip MËRKURI | Veçori sintaksore në ligjërimet e Toskërishtes Veriore (areali i Përmetit).... | 169 |
| Anila KANANAJ | Tipare të foljeve: të dhëna sintaksore nga të folme gege dhe toske..... | 181 |
| Paneli 1 □ | | |
| Mustafa IBRAHIMI | Mbi disa veçori sintaksore të së folmes së Prilepit dhe Krushevës..... | 197 |
| Maria S. MORZOVA | Sintaksa e të folmeve të diasporës shqiptare: disa tipare të së folmes së shqiptarëve të Ukrainës..... | 209 |
| Izmit DURMISHI | Vështrime sintaksore të së folmes së Gostivarit me rrethinë..... | 239 |
| Anyla SARAÇI (MAXHE) | Veçori sintaksore të së folmes së Devollit..... | 249 |
| Monika HASANI | Tipare sintaksore të çamërishtes..... | 261 |
| Majlinda BUSHAJ | Dukuri dialektore me interes sintaksor nga e folmja e Postribës..... | 267 |
| Llesh DOÇI | Tipare të sintaksës në zonën e Lurës..... | 295 |
| Mirjana UKPERA PEKA | Tipare sintaksore të së folmes së Hasit.... | 307 |
| Miranda HASANAJ | Tipare sintaksore në të folmen e Reçit të Dibrës..... | 317 |
| Ismet OSMANI | Veçoritë sintaksore të së folmes së Dërvenit të Shkupit..... | 327 |
| Paneli 2 | | |
| Asllan HAMITI | Tiparet sintaksore të së folmes së Karadakut të Shkupit..... | 339 |
| Idriz METANI | Disa veçori sintaksore të të folmes së Skraparit..... | 367 |

| | | |
|--------------------------|--|-----|
| Meleq SHOPI | Dukuri sintaksore të së folmes së qytetit të Elbasanit..... | 373 |
| Fridrik DULAJ | Çështje sintaksore nga e folmja e Rahovecit me rrethinë..... | 385 |
| Ajten HAJDARI- QAMILI | Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës..... | 391 |
| Sadat AGUSHI | Tipare sintaksore të së folmes së Preshevës me rrethinë..... | 417 |
| Aida KURANI | Veçori të periudhës me nënrenditje në studimet e sintaksës dialektore..... | 427 |
| Ilirian MARTIRI | Të dhëna për paraqitjen e tipareve sintaksore në studimet dialektologjike shqiptare..... | 435 |
| Valbona KALEMI | Dukuri sintaksore të së folmes së Kardhiqit (Gjirokastër)..... | 441 |

Prof.dr. AJTEN HAJDARI-QAMILI

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare

Universiteti "Shën Kirili e Metodit" - Shkup

MAQEDONI

**TIPARE SINTAKSORE TË TË FOLMEVE TË RRETHIT
TË STRUGËS**

SHKURTESA:

t – toskërishte

g – gegërishte

q- e folmja e qytetit

Vel. – fshati Veleshtë

Kor. – fshati Koroshishtë

SHENJA TRANSKRIPTIMI:

ôu – diftong (ou)

êi / ôi – diftong (ëj / oj)

eⁱ – diftongoid i prapavendosur i e-së

i^e – diftongoid i prapavendosur i e-së

o^u – diftongoid i prapavendosur i o-së

u^o – diftongoid i prapavendosur i u-së

ô – /o/ shumë e hapur

Struga ndodhet në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë dhe shtrihet përreth brigjeve të liqenit të Ohrit dhe të lumit Drini i Zi. Nga të gjitha anët është e rrethuar me male: në perëndim me Jabllanicën, në veri me Karaormanin dhe në lindje me Galiçicën dhe Debërcën. Në anën juglindore lidhet me qytetin e Ohrit, në veri me Dibrën, kurse në perëndim kufizohet me R. e Shqipërisë. Fushëgropa e Strugës ka sipërfaqe prej 226 km² dhe gjendet në lartësi mbidetare prej 695-800 m. Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002 në qarkun e Strugës ka pasur 63 376 banorë, prej të cilëve 56.50% janë shqiptarë, 32% janë maqedonas, turq 6%, vllleh 1%, romë, 0.18%, serbë 0.16%, boshnjakë 0.16% dhe të tjerë 4%. Kurse vetëm qyteti ka 33 000 banorë. Kjo shifër është pak a

shumë e njëjtë edhe sot (në vitin 2016) pra, mbi 63 000 banorë, sipas informatave që siguroam në zyrat e Komunës së Strugës.

Rrethin e Strugës e popullojnë folës të gegërishtes qendrore dhe të toskërishtes veriore, gjegjësisht fshatrat shqiptare të rrethit të Strugës në anën veriore dhe verilindore apo në anën e djathtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi janë gege (Dollogozhdë, Livadhi, Koroshishtë, Mislodezhdë, Zhepin, Poum, Tatesh i Epërm, Tatesh i Poshtëm, Bixhovë, Novo Sellë, Bogovicë, Dobovjan, Belicë e Poshtme, Labunishtë, Veleshtë)¹, kurse në anën jugperëndimore, gjegjësisht fshatrat në anën e majtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi janë toske (Ladorisht, Frëngovë, Kalisht, Zagraçan, Shum, Teferiç). Po, vallë, e folmja e shqiptarëve të qytetit duhet të përcaktohet si: toske, gege apo kalimtare? Në dialektologjinë shqiptare dhe në Atlasin Dialektologjik² është trajtuar si toskërishte veriore ose nuk është përmendur fare, sepse vjelja e materialit dialektor në këtë rreth është bërë përkritazi për shumë arsye, si: koha e shkurtër e hulumtimit, bashkëpunëtorët vendas të vjelësve nuk kanë qenë edhe aq adekuatë, faktorët jashtëgjuhësorë nuk janë marrë parasysh sa duhet, (si p.sh. ndikimet prej mësuesve nga Korça, Pogradeci dhe Elbasani) dhe përcaktimi është mbështetur kryesisht nga të dhënat e vjela nga fshati Ladorisht. Është e vetëkuptueshme se përcaktimi i të folmeve të qyteteve paraqet një vështirësi të madhe për shkak të popullsisë së përzier, imigrimit dhe emigrimit të vazhdueshëm nga zonat e ndryshme përreth, por edhe më larg. Po ashtu, të folmet e qyteteve, në krahasim me të folmet e fshatrave, shumë më tepër u janë ekspozuar ndikimeve të ndryshme gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, pikërisht për shkak të faktorëve të lartpërmendur, por edhe për shkak të: martesave të përziera, arsimimit të popullsisë në qendra të ndryshme kulturore, turizmit etj.

¹ Belica e Poshtme, Labunishti dhe Veleshta ndodhen në anën e majtë të rrjedhës së lumit Drini i Zi, por janë në anën veriore të Strugës dhe janë shumë afër fshatrave të tjera gege, kurse nga fshatrat toske janë tepër larg dhe nuk kanë rrugë lidhëse me këto të fundit.

² Në Atlasin Dialektologjik të Shqipërisë është përfshirë vetëm fshati Ladorisht dhe është shënuar me formën sllave Radolisht, kurse fshati Koroshishtë është regjistruar si Koroshishtë, por nuk ka fare të dhëna, përpos të dhënave që janë përgjithësuese.

Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës




Foto. 1. Harta e pjesës perëndimore të Maqedonisë

Sipas një studimi më shumë se 10 vjet në terren për të folmet shqipe të rrethit të Strugës, të folmen e qytetit të Strugës e kemi përcaktuar si kalimtare dhe jo si toskërishte veriore, sepse parakusht për këtë është vendndodhja e qytetit në mes dy dialekteve (toskërishtes veriore dhe gegërishtes qendrore), ndërsa dominimi i elementeve të toskërishtes është për arsye se fshatrat toske janë më afër qytetit, kurse për të arritur në fshatrat gege duhet kaluar nëpër disa fshatra maqedonase. Në anën tjetër, shpërngulja e vazhdueshme e popullsisë nga rrethina në qytet, të cilët më shumë janë gegë, por edhe toskë, bën që e folmja e qytetit të bëhet e larmishme me synim të një shkrirjeje mes veti.



Foto. 2. Harta e rrethit të Strugës

Këto përfundime bazohen në fakte të analizuara dhe të pasqyruara në disertacionin e doktoratës time dhe në disa kumtesa të botuara, saktësisht bëhet fjalë për dallime të: 19 tipareve fonetike, 14 tipareve morfologjike dhe 142 dallime leksikore mes tri të folmeve të Strugës.³ Kurse objekt studimi i kësaj kumtese është të pasqyrojmë vetëm tiparet sintaksore të këtyre tri të folmeve. Me qëllim që të bëhet më e qartë dhe për ta shikuar paralelisht secilin tipar në të tria të folmet, tërë analizën e kam paraqitur në mënyrë tabelare. Materialin dialektor e mblodha nëpër

³ Për këtë më gjerësisht shihni: QAMILI, Ajten (2013) „E folmja e Strugës dhe e Ohrit dikur dhe sot“. Konferenca „Java e Shkencës 2013“, 14 – 18 maj 2013. Prishtinë: Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2013. 15-21; QAMILI, Ajten (2014) „Përcaktimi i të folmes së Strugës“. ANAS *Studia humanitatis*, 3-4, Shkup: Instituti Alb-Shkenca, 2014, 138-146 dhe HAMITI, A. & QAMILI, A. (2014) „Dialektologjia e gjuhës shqipe“. Shkup: UIShM.

Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës

fshatrat e këtij qarku të banuara me shqiptarë dhe në qytet, në bazë të pyetësorit të përshtatur nga “Udhëzuesi për kërkime në fushën e sintaksës popullore” botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë në vitin 1987, që na u dërgua enkas për këtë konferencë nga Qendra e Studimeve Albanologjike - Tiranë.

| Tiparet sintaksore | Të folmet toske | E folmja e qytetit | Të folmet gege |
|--|--|---|---|
| 1. Folja-kallëzues bëhet në shumës, kur kryefjala është emër përmbledhës | a. Milet i ishte zgjuër. d. Djemuria u nisën. | a. Milet i ishte ngnitur. (as c. as d., sepse fare nuk përdoret ky emër përmbledhës) | b. Insanllëiku ishin squjt. / Milet i ishin ngrëit. d. Gjëmnia u nōisën |
| 2. Emri i rasës kallëzore me parafjalën “në”, “mbi” që ndiqet nga një emër tjetër në rasën gjinore ose nga një mbiemër, vihet në trajtën e pashquar | a. Ra qenartë gjolit c. Ypi në kala t’Ont | a. Ra në breg të Drinit c. Ypi në kala të Ohrit | a. Ra n’breg t’proit c. Ipi n’kala t’Ont |
| 3. A përdoren format me ose pa parafjalë | a. Nji thes gurë d. Lugë pe druni | b. Nji thes me gur/n d. Lug pe druni | a. (e gjeta) ni thes grun; b. (ma dha) ni thes me grun c. Lug druni (Vel.50%) ⁴ d. Lug pi druni |
| 4. Rrethanori i kufizimit ndërtohet në | (as a. as b., sepse përdoret): Shtatmadh | (as a. as b., sepse përdoret): Trupmadh | a. I madhka shtati (në Kor.) d. Ka lujt |

⁴Në fshatin Veleshtë paralelisht përdoren të dyja format pa pasur ndonjë dallim semantik më të përpiktë, thjesht i lihet parapëlqimit të folësit se cilën do ta përdorë, prandaj kemi shkruar 50%.

AJTEN HAJDARI-QAMILI

| mënyra të ndryshme ⁵ | | | mendsh (në Vel.) dh. E ka lujt menden |
|--|---|--|---|
| 5. Kallëzuesi vihet në shumës në ndërtimet e tipit: | dh. E ka lojtur mendjen b. Gjyshi me të birin u nisën | dh. E ka lojt mendjen b. Xhyshi me birin e vet u nisën | b. Xhishi me (birin) vocin e vet u nëisën |
| 6. Kryefjala me kallëzuesin përshtaten në renditjet e tipit: | b. Si i miri si keqi barabar e kanë pasur akun d. Pas meje kanë ardhur edhe i miri edhe i keqi | b. Si i miri si keqi baraz e kanë pas akun d. Mbas meje kanë ardh edhe i miri edhe i keqi | b. Si i mëiri si i k ⁱ eçi nis ^u oj e kanë pas (h)akun d. Mbas mije kanë ardhun ene i mëiri ene i k ⁱ eçi |
| 7. Rrethanori i vendit që shënon drejtimin e një lëvizjeje përdoret me parafjalë | a. Zbrita / rash në Strugë c. Shkova nd'Ont Shkova në Tiranë | a. Zbrita në Strugë c. Shkova në Ohër Shkova në Tiranë | a. Zbrita n'Strugë c. Shkova n'Ohër Shkova n'Tiranë |
| 8. Rrethanori i shkakut përdoret me parafjalë | as a. as b. Vdiq për bukë / Shkoi i unitur c. Plasa pe vapës | a. Vdiq pe të untit / vdiq për buk. c. Plasa pi së nxitit; plasa pe të nxitit. | a. Vdiq pi untsëie / vdiq ka untsëia / ngordhi për buk. c. Qasa pi t'nxeti |
| 9. Parafjalët <i>tej</i> dhe <i>përtej</i> nuk përdoren fare, por përdoret <i>matanë</i> dhe lidhet me rasën rrjedhore | b. Mbatan udhës c. Mbatanë malit | b. Matan rugës c. Matan malit | b. Maton udhës / rugës c. Maton malit |
| 10. Përdoret rasa vendore ose | b. Shkoj në mal(t) | a. Shkoj në mal | a. Shkûoj n'mal |

⁵ Në pyetësor për këtë pyetje kemi katër alternativa, por meqë në këto të folme përdoret një formë tjetër, gjejmë përdoret ndërtimi me emër në rasën kallëzore, prandaj kemi shtuar alternativën **dh**.

Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës

| | | | |
|--|---|---|---|
| kallëzore me parafjalëtnë, mbi, nën, me | Ay shkoj në shtëpi c. Ypi në fiq d. I ypi në kokët f. Doli mbë udhët | c. Ypi në fiq ⁶ e. Në rug/ në udhë | c. Ipi n'ç'erre as c as d. Ipi ke fiçi / ipi ke dardha (me rasën emërore) e. N'rug/ n'udh |
| 11. Trajta e shkurtër në shumicën e rasteve e përsërit kundrinë | b. Ay e zhgonte librën ⁷ c. Bleu dy xhama f. Më mori mua h. Të ka lën(ët) ⁸ tye | b. Ay e shifte librën c. Bleu dy gota f. Më mori mua h. Të ka lën tye | b. Aj e shëifte librën d. I gjeu dy/di bilure f. Më mo ^u r m ^o uve h. T'ka lon tēi |
| 12. Trajta e shkurtër “më” e vetës I njëjës me folje në mënyrën urdhërore përdoret edhe si proklitike edhe si enklitike, por me dominim enklitik (janë para qitur me përqindje sipas dendurisë së përdorimit) | a. Ma idh 10% b. Idhma 90%, c. Më ço 50% d. Çomë 50% e. Ma kap 25% f. Kapma 75%, g. më prit 40% h. Pritmë 60%, i. Më sill 40% j. Sillmë 60% i. më bjer 40% j. Bjermë 60% Nëma 90% | a. Ma fug 10% b. Fugma / idhma 90% c. Më ço 50% d. Çomë 50% e. Ma kap 25% f. Kapma 75%, g. më prit 40% h. Pritmë 60%, i. Më sill 40% j. Sillmë 60% i. Më bjer 50% j. Bjermë ⁹ | a. ma fug / fug 10% b. Fugma 90% c. t'ëm çojsh 50% d. Çom 50% e. Ma kap 25% f. Kapma 75% g. m'prëit 40% h. Prëitëm 60% / / i. ma gjer / ma bjer ¹⁰ |

⁶ Karakteristike për tri të folmet e rrethit të Strugës është se edhe për njëjës edhe për shumës përdoret forma *fiq / fiç*, kurse *fik* nuk përdoret fare.

⁷ Veçori për gjeneratat më të shtyra të këtyre të folmeve është se emri *libër*, disa nga mbaresat rasore i bën sikur të ishte emër i gjinisë femërore, por gjeneratat e reja e përdorin formën e drejtë.

⁸ Në disa nga fshatrat toske përdoren format epentetike të foljeve, sidomos në fshatin Kalisht.

⁹ Fjala *bjermë* ose *më bjer* në të folmen e qytetit përdoret kryekëput për të rënë, pra goditje me grusht, shpullë apo diçka tjetër, kurse në të folmet toske dhe gege përdoret edhe për të sjellë diçka: *më bjer ni xham / bilure ujë*.

| | | | |
|--|---|---|---|
| | ma ep10% Më dëfte Thuemë, dëftemë 60% | Nëma 90% ma ep10% më trego 45% Tregom 55% | j. Gjerëm/ (bjerëm në Kor.) Nama 90% ma ep 10% Ma dëfto 35% Dëftom 65% |
| 13. Përemri pronor “i/e vet” në fjalinë e varur i referohet kundrinës së fjalisë drejtuese në rastin nën a), kurse në rastin nën b) i referohet kryefjalës së fjalisë drejtuese | a. Learti i tha Anianit të vete në fshatin e vet (në shpit të vet). b. Anila ia rëfeu Vjollcës librën e vet/ e sajt. | a. Learti i tha Anianit të shkoe në fshatin e vet (në shpin e vet). b. Anila ja dëfteu/tregoj Vjollcës librën e vet. | a. Learti i tha Anianit të shk ^u oe / shk ^o e n'katoundin e vet (n'shpëi t'vet). b. Anila ja dëft ^u oj Vjollcës librën e vet. |
| 14. Përemri pronor në fjalinë e varur “i tij/e saj” i referohet kryefjalës së fjalisë drejtuese | Gena i tha Blertës t'i shofi slika t e saja. Beni ia rëfeu Gonit arat e veta / e tija. | Gena i tha Blertës t'i shofe fotografia t e asaj. Beni ia dëfteu/ tregoi Gonit arat e atij / e veta. | Gena i tha Blertës t'i shofe slika t e asajt. Beni ja dëft ^u oj Gonit arat e veta. |
| 15. Përemrat dëftorë shoqërohen me emra të shquar ¹¹ | a. Ay çuni vin c. Ky çuni tha e. Ajo cuca u nis | a. Ay/aj çuni vin c. Ky çuni tha e. Ajo cuca u nis | a. Aj voci ¹² vëin / voin. c. Ki voci tha. e. Ajo cōuca u nēis. |
| 16. Kur kemi dy emra të shoqëruara me | a. Tre burra e tre gra të ftuëra. | a. Tre burra e tre gra të ftuara. | a. Tre burra en tre gra t'ftoume / t'fkatme ¹⁴ . |

¹⁰ Përdorim proklitik me këtë folje kemi vetëm kur emri të cilës i referohet trajta e shkurtër është në trajtën e shquar, ndërkaq kur emri është në trajtën e pashquar përdoret forma enklitike.

¹¹ Në të folmet gege përemrat dëftorë në disa raste shoqërohen edhe me emra të pashquar, si p.sh.: *S'ëm duket mëir ki voc; Hiç nuk merr vesh kjo cōuc.*

¹² djali

Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës

| mbiemra, mbiemri i referohet emrit të fundit, pra merr gjininë e emrit të fundit. ¹³ | d. Tre gra e tre burra të ftuër. | d. Tre gra e tre burra të ftuar. | d. Tre gra en tre burra t'ftoumun/ t'fkatun. |
|---|---|---|---|
| 17. Forma e pashtjelluar "me të ardhur" nuk përdoret me vlerë të një fjalisë kohore të njëkohësisë, por përdoren vetëm fjali kohore me lidhëzën "sa" (lidhëzat "sapo" dhe "posa" nuk përdoren fare) | a. Sa mbëniu atje, ay e mori. c. Sa yri në fshat, thëmiti me të madhe. | a. Sa mbëriui atje, ay e mori. c. Sa yri në fshat, bërtiti me të madhe. | a. Sa mbrëini agje, aj e mōur. c. Sa ini n'katōund, fkatu / vrrōiti ¹⁵ me t'madhe. |
| 18. Ndërtimi me formën e pashtjelluar "një të thënë" përdoret me vlerë të një fjalisë kohore të njëkohësisë, por përdoren edhe fjalitë kohore lidhëzore | a. Sa e tha, u nis. 55% b. Nji të thënë, u nis. 45% c. Sa e pa, e qirati/ qerasi. 55% d. Nji të parë, e qirati 45% Nji të ardhur, zuri të bërtasi | a. Sa e tha, u nis. 65% b. Nji të thënë, u nis. 35% c. Sa e pa, e qerasi / e çastiti. 55% d. Nji të parë, e qerasi / e çastiti 45% Nji të ardhur, zuri të bërtase | a. Sa e tha, u nis. 55% b. Ni t'thonme, u nëis / nôis. 45% c. Sa e pa, e çastëiti. 55% d. Ni t'pame, çastëiti. 45% Ni t'ardhme, zuni / zu t'bërtase / |

¹⁴ Fjalët *fkata*, e *fkatun* burojnë nga fjala sllave *вѣка* "thërrët, bërtet" që ka evoluar: *vikas* > *vkas* > *fkas*, në raste më ekstreme në disa fshatra shkon deri në *thkas*.

¹³ Në të gjitha të folmet e Strugës numëroni tre nuk dallon gjini, përdoret vetëm e gjinisë mashkullore (tre).

¹⁵ Fjala *vrrōitte* është tipike vetëm për të folmen e fshatit Veleshtë dhe Dobovjan, që ka kuptimin *bërtiste*. p.sh.: *Aj vrrret*. (Ai bërtet).

| | | | t'vrrase |
|--|--|---|--|
| 19. Përdoren vetëm fjalitë kohore lidhëzore dhe jo ndërtimi me emra prejfoljore asnjans në trajtë të shquar pa parafjalë | a. Sa zbriti poshtë, u vra. c. Sa yri ajo brenda, u shojt drita. e. Sa doli dielli, lefi qeni. | a. Sa zbriti posht, u vra. c. Sa yri ajo mbrenda, u shujt drita. e. Sa doli djelli, lefi çeni. | a. Sa zdripi posht, u vra. c. Sa ini aj ^u o mbrenda, u shim drita. e. Sa dul dilli, l'efi ç'eni. |
| 20. Në togjet foljore në të cilat përbërësi i parë shpreh fillimin e veprimit (zë, nis, filloj, hyj) përdoret më shumë forma parataktike e më pak ajo hipotaktike ¹⁶ | a. Ze të bërtasi c. Yn të ajë. e. Nis të foli (ay). g. Ze(n) të qajë. i. Fillon të thërrasi 50% j. Ze e thërret | a. Zen të bërtase c. Yn të ae. d. Ulet e an si i ziosur. e. Nisën të fole. g. Ze(n)/ fillon të qae. i. Fillon të bërtase | a. Ze t' bërtase 50% b. ze e vret 50% c. Int ^h ae. d. Unjet e ^h a si i ziosun. e. Nêis t' f ^u ole. g. Fillon / Zen t' qae. h. Ze e qan i. Nôis t' thkase / Nêis t' fkase j. Ze e vret |
| 21. Në këto ndërtime kallëzuesi foljor shprehet vetëm me formë të shtjelluar | a. Zuri të kërkojë c. Nisi/zuri të qajë e. Filloi të pijë g. Nisi të këndojë | a. Zu(n) të kërkoe c. Nisi/zu(n) të qae e. Fillovi të pie g. Nisi të këndoe | a. Zu t' kërkoe c. Nêisi / zu t' qae e. Filloj t' pëe / t' poe g. Nêisi t' këndoe / t' këndue |
| 22. Në fjalitë e pavarura pyetëse kallëzuesi shprehet me formë të shtjelluar | a. Ku të shkoj? c. Çartë boj? e. Ce / Përse të vish? | a. Ku të shkoj? c. Çartë boj? e. Ce / Përse të vish? | a. Ku të shk ^u oj? c. Çish t' boj? e. Ce / Përse t' vëish? |
| 23. Fjalitë | Të mdhajati | Të mdhajati preu, | T' mdhinjat / |

¹⁶ Në të folmet gege mund të thuhet se, sa përdoren format parataktike, po aq përdoren edhe format hipotaktike.

Tipare sintaksore të të folmeve të rrethit të Strugës

| | | | |
|---|---|--|---|
| bashkërenditëse kundërshtore shprehen edhe në mënyrë jolidhëzore | preu, të voglat i rojti Ay tha e marr unë, ky tha e marr unë | të voglat i ruji Ay tha e mar ¹⁷ une, ky tha e mar une | t'ndhonjati i preu, t'voglat i ruji Aj tha e marr ôun, ki tha e marr ôun |
|---|---|--|---|

23. Lidhëzat që përdoren në të folmet e rrethit të Strugës për periudha me fjali bashkërenditëse janë:

a) **lidhëza shtuese** : e, dhe, edhe (t, q) / en, ene (g), edhe ... edhe (t, q) / ene ... ene (g), em ... em, as .. as, si ... ashtu edhe ... / si ashtou ene
p.sh.: **periudha këpujore**: *Ayna na vdiq, çuni vllait tem edhe më mbeti e keqja në barkut.* (t) *Neve nuk na shef, as nuk na fol.* (t) *Ajo nusja sun dali në pragn e derës, jo për punë, po as për qef sun dali.* (t) (periudhë këpujore me ngjyrim shkallëzimi). *Kishte qonun ni qak ene i kishte çôumun vocat (gjemt) n'mal për dru.* (g) *Minjirend ka ik pi shpoes en kërkont s'un shkue.* (g)

- **fjali këpujore asindetike**: *Ajo murga nuse¹⁸ e ndërron, e bon, e yshqen.* (t)

b) **lidhëza veçuese**: a, o ... o, ja ... ja, n'daç... n'daç/ daç...daç, ose...ose, o...o.

O do/dë shkujm o do/dë rrim këtu (t, q) / *O dë shkujm o dë rrëjm ktôu* (g). *Ja lue ja mos lue!* (t) / *Ja luj ja mos luj!* (q) / *Ja luj ja mo luj!* (g). *N'daç ajde n'daç mos ajde!*

c) **lidhëza kundërshtore - përqsore**: kurse, po, veç, vetëm, vetëmse, ama / amo(n), mirpo/mëirpo, a.

p.sh.: *Un të thash, po ti s'më ndërngjove* (t) / *une të thash po ti s'më ndëgjove* (q) / *Ôun t'thash, po t'ei s'm'g'egje* (g); *Shko, vetëm mos shpeto!* (t) / *Shko, veç mos shpejto!* (q) / *Shko, veç mo u ngjut!* (g). *Mir ësh, ama mundeshte edhe më mir.* (t, q) *Mëir o: /osht /oshtën* (Doll.), *ama moundeshte ene ma mëir.* (g); *Më përpara pleqët ishin më të sert, mirpo kishte më shum rend* (t) / *Ma para qieçt ishin ma t'sert, mëirpo kishte ma shom rend* (g). *Neve nuk na shef, ama po të ke:t zhu:rm gjikundi trembet, për të trembur, trembet.* (t). *Do te qajsh edhe t'e*

¹⁷ Në të folmen e qytetit nuk përdoret dridhësja /rr/.

¹⁸ Karakteristike për të folmet toske është se disa mbiemra vendosen para emrit: *murga nuse*.

*mbajsh në barkut, alli*¹⁹*neve vdekje kemi përdite. (t) Cuca u fërcua, a ni veçkë s' dinte të bojë. (t) Ne fkatëm, e fkatëm, amon kërkush s'erdh. (g) Oün sade mushknojat i kom hongër, mëvpo si kom quon... (g).*

- **fjali kundërshtore-përqsore asindetike:** *I rash ni nat mobillit, nuk e ngrete. (g)*

ç) **lidhëza përmyllëse:** për atë / përçat, pandaj / prandaj / prëndi (përqëndëi):

p.sh.: *Ke punuër shu:m, pandaj je lodhur (t) / Ke punu(ar) shu:m, prandaj je lodh (q) / Ke punōumun shōum, prëndi / përqëndëi je lūodh(un) (g). Ajo ishte zemëruër, për atë nuk erdhi. (t) / Ajo ishte zemruar / idhmuar, për atë nuk erdhi. (q) / Ajūo ishte idhnōumun, përçat s'erdh. (g) Dhëndrri çunin e kishte të vogël, pandaj burri im vinte te çeshme xhamis m'i sillte dru:t. (t)*

d) **lidhëza shkallëzore :** jo vetëm që... po edhe ... / j^uo vetëm ç'i ... po ene..., jo vetëm që... po as ... / j^uo vetëm ç'i ... po as ..., lere që s' ... po as nuk ... / line ç'i s' ... po as nuk.

p.sh.: *Ay jo vetëm që s'rrëfeu asgjë, po edhe iku pa u përshëndetur (pjekur) (t) / Ay jo vetëm që s'tregoi asgjë, po edhe iku pa u përshëndet. (q) / Aj j^uo vetëm ç'i s'dëftuoj asnisend, po ene iku pa u përshëndet. (g) Jo vetëm që s'di, po as nuk mëson. (t) / Jo vetëm që s'di, po as nuk mson. (q) / Jo vetëm ç'i s'di, po as nuk mson. (g) Lere që s'ka pare, po as nuk punon. (t, q) / Line ç'i s'ka pare, po as nuk punon. (g).*

24. Lidhëzat që përdoren në të folmet e rrethit të Strugës për periudha me fjali nënrenditëse janë:

- **lidhëzat ffilluese:** se, që/ç'i;

- **lidhëzat vendore:** ku, te / ke, nga / ka, gjer (t) / deri (q) / njer (g); gjithande nga / xhiandi ka (g); pe / pi, pi ku / pe ku; gjer ku / njer ku, pe nga / pi ka,

- **lidhëzat kohore:** kur/ kour, sa, si, mbas, pasi, para se; gjersa / dersa / njersa; kurdo që / ç'i; sa er që / sa er ç'i;

- **lidhëzat shkakore:** se, si, mbasi/pasi, ce;

- **lidhëzat qëllimore:** ç'i / që, se, ce, për t'...;

- **lidhëzat krahasore-mënyrore:** sa; se, sesa; si, sikur, sikurse / sikōundra, ashtu si,;

- **lidhëzat kushtore:** sikur, po, nëse, në, n'qofse, po të, n'rase;

- **lidhëzat rrjedhimore:** kshu që, ashu që / astou ç'i, sa që / ç'i ;

¹⁹ Lidhëza *alli* buron nga turqishtja *albuki*.

- **lidhëzat lejore:** edhe pse / ene pse, sado që / ç'i, edhe po / ene po, edhe në, edhe sikur / ene sikur

- **lidhëzat kundërshtore, kundërvënëse:** në vend që (t, q) / n'vënd ç'i (g).

Sikurse në shumicën e të folmeve shqipe, edhe në të folmet e rrethit të Strugës përdoren periudhat me fjali:

1. Kryefjalore
2. Kallëzuesore
3. Kundrinore
4. Përcaktore
5. Rrethore:
 - 5.1. Vendore
 - 5.2. Rrjedhimore
 - 5.3. Kohore
 - 5.4. Kushtore
 - 5.5. Mënyrore
 - 5.6. Lejore
 - 5.7. Shkakore
 - 5.8. Qëllimore
 - 5.9. Krahasore

Të gjitha këto mund të përdoren me ose pa lidhëza (asindetike). Sa për ilustrim po japim disa shembuj:

Fjali kundrinore asindetike: *Dëftoshin kta ke Luti, paska shkôu Xhelali gje pi mbas içëndoe njer kur erdh vakti akshomit ke Nuni.* (g) T' rrëi un, t' çaj kokën.

Fjali përcaktore: *Ato lule ç'i u mbôillën, s'u b^uon.* (g)

Fjali kohore: *Kur ishëm të reja ja si juve të mira s' kemi pa:r.* (t) *Kur s' ka kush dët ndëife/ a ke zor/ ater msoesh ene e sos pounën vet.* (g) *Ja, kur t' shkôojm ka Struga dë ta shofish.* (g) *Çi ôune ma pa:r, sa ëipte drita shefak, ôun n' kom isha.* (g) *Sa her shkote ki n' poun, ôun n' kom isha.* (g)

Fjali kushtore: *O ba:b, po t' na prëishet ç'errja ne s' dëm ta gjodisim.* (g) *Po mo ken pare, z' do t' i bojn.* (g) *Ata po s' i ujnte, s' b^uoen.* (g) *N' munça nesër t' ngrejëm n' saba jerët, mëv o:.* (g)

Fjali kushtore asindetike: *Të m' i teki njeri, di të rrëfej prralla.* (t) *Po qau, ja ve gjëjat pe dyqani, projti.* (t)

Fjali shkakore asindetike: *Nji çik kos i japim me të zort, qumësh nuk pin.* (t)

Si përfundim mund të themi se të folmet e rrethit të Strugës në paradigmën e veçorive dalluese fonetike, morfologjike dhe leksikore

dallohen njëra nga tjetra, por në rrafshin sintaksor të tria të folmet e rrethit të Strugës janë pothuajse të njësuara ose shumë të përafërta.

TEKSTE DIALEKTORE TË RRETHIT TË STRUGËS²⁰

Në vazhdim po japim vetëm disa fragmente shumë të vogla të teksteve dialektore të vjelura në terren, sa për të pasur një pasqyrë më të qartë të të folmeve të këtij rrethi.

Po s'di me²¹ bi:²² un prralla, s'di. Të m'i teki²³ njeri, di të rrefej prralla, po këshu vet s'di. Tjetër sh'të tregoj me bi:, viranllëk, nje²⁴ shëndetin tem²⁵ ta tregoj. Në vakët²⁶, nje ashtu, kur ishim të reja ja si juve të mira s'kemi pa:r. E keqja mëmbeti, ja ala²⁷ e kam. Ayna²⁸ na vdiq, çuni²⁹ vllait tem edhe mëmbeti e keqja në barkut. E di si ay lepun qi idhet? Nje ashu mua barku më idhet. Me apje po rroj. E nje ashusoj. Çuni i sëmur shtir ësh, pe atje shkon atje, siç është rëshqinja³⁰ njer në bark, njer në kumiz, e thau edhe kokën, i bie kokës me oft³¹, me bij. Të shofi³², shefën çuni këshu mi:r, siç thonë, ama neve nuk na shef as nuk na fol, ama po të ke:t zhu:rm gjikundi trembet, për të trembur trembet. Po të qajn fëmijët edhe ay ze qan. S'është jet me bij, neve e di:m edhe Allau.

Nje kjo e keqe q'e kemi, kët të keqe njeriut... mos ia thëntë Zoti, se vdes njerët³³, epo do te qajsh, do te qajsh edhe t'e mbajsh në barkut. Alli³⁴ neve vdekje kemi përdite. Ajo nusja sun³⁵ dali në pragn e derës, jo për punë, po as për

